



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

C.nr.4665/2020

Numri i lëndës: 2020:141611
Datë: 03.06.2021
Numri i dokumentit: 01974692

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile të paditësit Rr. N., nga P., përfaqësuar nga F. S., avokat në Gj., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga R. G., me objekt të kontestit kompensimin shpërblimit jubilar, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 818.84€ (tetëqindetetëmbëdhjetë euro e tetëdhjetekatër euro/cent), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur me datë 03.06.2021, në seancë publike, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe të përfaqësueses të së paditurës, të njëjtën datë dha këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. N., nga P., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensoj shumën prej 818.84€ (tetëqindetetëmbëdhjetë euro e tetëdhjetekatër euro/cent), me kamatë vjetore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të paditës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 259.00€ (dyqindepesëdhjetenëntë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datën 23.08.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit që në

emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensoj shumën e mbetur prej 818.84€ (tetëqindtetëmbëdhjetë euro e tetëdhjetekatër euro/cent), me kamatë vjetore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të paditës e deri në pagesën definitive. Në padi ka potencuar se paditësi është i punësuar tek e paditura në QKMF në Prishtinë dhe se e paditura në bazë të KKS është e obliguar që paditësit t'ia paguaj në pagë në emër të shpërblimit jubilar. Andaj bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale për Shëndetësi, të njëjtit i takon për mbi 10 vite të përvojës së punës, shpërblimi jubilar në lartësi të një page mujore të tij.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke i propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 78.00€, për një përfaqësim në gjykatë shumën prej 104.00€ dhe shumën prej 20.00€ në emër të taksës gjyqësore për padi.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar duke shtuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet refuzuar, pasi që një kompensim i tillë nuk është paraparë me ligjin e punës. Ka theksuar se e paditura në skemën e saj buxhetore nuk ka paraparë linje të posaçme për këtë lloj të kompensimit, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: kontratën e punës nr. 377, të datës 26.02.20213, vërtetimin nr. 2495, të datës 29.09.2020, kërkesën nr. 1885, të datës 16.07.2020, përgjigjen në kërkesë nr. 1968, të datës 22.07.2020, listën e pagës për paditësen nga buxheti i Kosovës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, çmuarjes me kujdes e ndërgjegje të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që me provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura. Kjo u vërtetua edhe nga kontrata e punës nr. 377, të datës 36.02.2013. Gjithashtu, gjykata gjeti se paditësja ka 21 vite përvojë pune. Këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit nr. 2495 të datës 29.09.2020.

Nga faktet e vërtetuara si me lartë gjykata ka ardhur në përfundimin së kërkesëpadia është tërësisht e bazuar.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj).

Neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: “KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”.

Me nenin 17 paragrafi 3 pika 2 të KKS parashihet se: Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 20 vjet të përvojës së punës në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij”. E sipas paragrafit 4: “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i këtij shërbimi shëndetësor t’ia paguaj një pagë në emër të shpërblimit jubilar. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 17 paragrafi 3 pika 1 të KKS-së. Për më tepër paditësi ka më tepër se 20 vite përvojë pune të pandërprerë, pra ka mbushur

vitet e nevojshme të përvojës së punë për shpërblim jubilar sipas nenit 17 paragrafi 3 pika 3 e KKS-së.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës si në pikën II. të dispozitivit, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452, të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Duke qenë se nga dy shqyrtimet e mbajtura, njëri është shtyrë me shkas të vet paditësit për shkak të zgjerimit të padisë, Gjykata vlerëson se nga shpenzimet e kërkuara, paditësit i takon e drejta për përfaqësim në një shqyrtim gjyqësor në shumë prej 135 Euro. Po ashtu, paditëses i takojnë shpenzimet për taksën gjyqësore në shumë prej 20 euro, si dhe për padi në shumë prej 104 euro.

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.4665/2020, më 03.06.2021

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.